

## Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 11.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.08.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “SIGONI SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 21 1907 111 nxjerr:

### VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “Sigoni SHPK”, të dt. 06.08.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës”, me Nr. 616 21 1907 111 kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 03.08.2021 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj aktivitetin e prokurimit*;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Grupi i Operatori Ekonomik “ Sigoni SHPK ” me datë 06.08.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, prodhimi dhe vendosja e numrave të adresave në Komunën e Prishtinës urnizim dhe montimi me paisje për Institucionet vartëse te Drejtorisë së Kulturës”, me Nr. 616 21 1907 111.


Autoriteti Kontraktues, me datë 11.08.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon :

- Pretendimi për validitet të Çertifikatës tuaj është i pa bazuar,pasi që edhe në bazë të dokumenteve që i keni cekur ju është e qartë se çertifikata juaj është me afat të skaduar dhe nuk është valide;
- Pretendimi lidhur me posedimin e çertifikatës ISO 14001 është i bazuar,pasi që në ofertë është çertifikata në emër të anëtarit “Malësia”;
- Pretendimi lidhur me standardet për stampim është i pa qëndrueshëm,pasi që komisioni profesional ka konstatuar se të njejtat janë sipas çertifikatave të dorëzuara;
- Pretendimi lidhur me kontratën e Komunës së Prishtinës ju sqarojmë se është i pa bazuar ,pasi që Autoriteti Kontraktues dhe përfaqësuesit e Njesisë së kërkesës në komision kanë dëshmi të shkruar se ajo kontratë është realizuar;
- Pretendimet lidhur me saktësinë e dokumentit nga 3 M poashtu janë të pa bazuara,pasi që nuk mund të verifikohet ajo saktësi nga ne.Lidhur me këtë vetëm ju sarojmë se ju keni dokument nga 3M në Zvicër ,ndërsa i rekomanduari për kontratë nga 3M në Gjermani dhe ndoshta për këtë mund të jetë ndryshimi në formulim të dokumentit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit